



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1356/1 prot.

Tiranë më 20.9.2019

Lënda: Kthim përgjigje mbi kërkesën për opinion ligjor mbi konfidencialitetin
statistikor.

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.1733 Prot., datë 06.09.2019, me anë të së cilës kërkohet opinion lidhur me çështjen e trajtimit të konfidencialitetit statistikor në raport me akte të tjera legjislative dhe konkretisht me ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", pas rrethanave të parashtruara nga ana juaj në këtë shkresë, por edhe gjatë takimit të zhvilluar mes përfaqësuesve të dy institucioneve, Zyra e Komisionerit ju përcjell vlerësimet e mëposhtme.

Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në përmbushje të qëllimit të tij, vë në lëvizje çdo autoritet publik, që nëpërmjet dokumenteve që prodhon apo administron, të bëjë transparente veprimtarinë apo performancën e punës institucionale. Informacioni statistikor i nënshtrohet detyrimeve që burojnë nga ligji për të drejtën e informimit si dhe kufizimeve të parashikuara prej tij. Pika 2 e nenit 17, parashikon se kufizimi mbi të drejtën e informimit nuk zbatohet kur të dhënat janë fakte, analiza të fakteve, të dhëna teknike ose të dhëna statistikore.

Në këtë kuadër, detyrimet që burojnë nga ligji për të drejtën e informimit, për të vepruar dhe trajtuar një kërkesë për informacion brenda një afati të caktuar i takojnë çdo autoriteti publik prodhues apo mbledhës i informacionit, përfshirë këtu edhe Institutin e Statistikave.

Lidhur me parimin e konfidencialitetit, si një ndër parimet kryesore të parashikuara në ligjin nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, duke e parë atë në raport me të dhënat statistikore, në kuptim të këtij ligji, por edhe nga praktika në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në Evropë, kur flitet për të dhëna statistikore nënkuptohen të dhëna që nuk e identifikojnë ose e bëjnë të identifikueshëm një person dhe që mund të aksesohen lirisht dhe pa pengesa ligjore. Kjo pasi aksesimi në të dhëna

statistikore nuk çënon privatësinë e individit për sa kohë nuk e identifikon atë në cilësinë e subjektit të të dhënave personale.

Në të njëjtën linjë edhe ligji nr.119/2014 *"Për të drejtën e informimit"* për kategorinë e informacionit të kufizuar, konfidencial në rastin konkret, ka shmangur mundësinë e refuzimit për të gjithë dokumentin, ose për të gjithë informacionin, duke i dhënë mundësinë autoritetit publik që të mbulojë/anonimizojë pjesë të caktuara, duke dhënë pjesën tjetër të dokumentit, në përmbushje të kërkesës për informim.

Sipas ligjit nr. 17/2018 *"Për statistikat zyrtare"*, të dhënat e mbledhura, të përpunuara dhe të ruajtura për nxjerrjen e statistikave zyrtare jo në çdo rast trajtohen si konfidenciale. Në referim, pika 1, e nenit 31 parashikon se: *"Të dhënat e shpërndara nga burimet e disponueshme publikisht nuk do të vlerësohen konfidenciale"*.

Akresi në informacion është njohur gjithnjë si një parakusht për transparencë dhe llogaridhënie të shtetit përpara publikut. Në këtë kuadër, autoriteti publik duhet të bëjë një analizë të mirëfilltë të asaj që lejohet të bëhet publike dhe asaj që ligji organik nuk lejon, në çdo kohë duke bërë balancën nëse prevalon interesi publik.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

